

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7980
E enjte, 30 janar 2025
Çmimi 0.50 €

Pezullimi i ndihmave amerikane ndihet në mbarë globin



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



BETEJA MILIONËSHE PËR VOTA



Fushata zgjedhore në Kosovë është garë milionëshe. Ndonëse partitë politike janë të obliguara t'i raportojnë shpenzimet, vëzhguesit e zgjedhjeve ngrenë

shqetësime për transparencën e donacioneve që ato marrin. Eugen Cakolli nga rrjeti i organizatave joqeveritare Demokracia në Veprim

(DnV) pret që fushata aktuale të jetë më e kushtueshme krahasuar me të kaluarat sepse, siç thotë, është fokusuar në marketing në sferën digjitale

OPINION

VOTA ËSHTË ARMA MË E FORTË PËR T'I MPOSHTUR ANTIVLERAT F.6

Shkruan:
Astrit GASHI



AKTUALE



HYN NË FUQI MARRËVESHJA PËR NJOHJEN E PATENTËSHOFERËVE NË MES TË KOSOVËS DHE ITALISË F.7

PUTINI THOTË SE ËSHTË I GATSHËM PËR BISEDIME TË PAQES, POR JO ME ZELENKYN F.2

EKONOMI



GËRHXHALIU: SANKSIONET E BE-së DHE NGRIRJA E NDIHMËS NGA SHBA-ja, GODITJE TË RËNDA PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM NË KOSOVË F.8

SPORT



KRASNIQI PRITET TË RIZGJIDHET NË KRYE TË KOK-ut F.10

KQZ-ja DHE INSTITUCIONET LIGJZBATUESE KOORDINOHEN PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT F.3



NATO-ja E GATSHME TË PUNOJË ME SORENSENIN SI NDËRMJETËSUES NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI F.3



RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Suedia synon të dërgojë të dënuar në burgje jashtë vendit

STOKHOLM, 29 JANAR - Suedia mund të dërgojë kriminelë për t'i vuajtur dënimet në burgjet jashtë vendit, tha një komision i emëruar nga qeveria më 29 janar. Ky shtet po përballet me vështirësi të menaxhimit të kapaciteteve në burgje për shkak të rritjes së numrit të të burgosurve të rinj, rritje që lidhet me një valë të krimeve të bandave. "Ka nevojë të punohet për gjetjen e zgjidhjeve të reja brenda Shërbimit të Burgjeve", tha ministri i Drejtësisë, Gunnar Strömmer, në një konferencë për medie. Strömmer tha se Suedia veçse është në bisedime me shtetet e tjera për marrjen me qira të

burgjeve të tyre, pa përmendur emrat e shteteve. Nga shtetet evropiane, edhe Danimarka, duke dashur ta lehtësojë situatën me mbipopullimin e burgjeve të saj, ka arritur marrëveshje me Kosovën për të marrë me qira 300 qeli në burgun në Gjilan. Megjithatë, kjo marrëveshje 10-vjeçare, nga e cila Kosova do të përfitojë rreth 200 milionë euro, ende nuk ka nisur së zbatuari. Ndryshe, Suedia po përballet me rritje të krimeve të bandave, krime që janë rritur në dy dekadat e fundit. Ky shtet është në mesin e shteteve me numrin më të lartë për kokë banori të dhunës me armë në Evropë.

Me miratimin e ligjeve të reja dhe rritjen e personelit dhe buxhetit, policia suedeze ka korrur sukses në luftën kundër bandave dhe në dy vjetët e fundit ka pasur më pak të shtëna vdekjeprurëse e më shumë dënime. Përderisa ky sukses është mirëpritur, sistemi i burgjeve të shtetit është mbingarkuar. Sipas të dhënave të fundit, që i përkasin vitit 2023, gjykatat suedeze kanë dënuar persona në një total prej pothuajse 200 000 muajsh burgim, që paraqet një rritje prej 25-përqindësh me vitin paraprak dhe dyfishim krahasuar me dënimet e shqiptuara më 2014. Burgjet dhe qendrat e



paraburgimit në Suedi janë në kapacitete të plota dhe Shërbimi i Burgjeve ka thënë se i duhen rreth 27 000 shtretër të rinj deri më 2033. Mattias Wahlstedt, kreu i

komisionit, tha se nuk ka pengesa ligjore që Suedia të marrë me qira qeli jashtë vendit, por propozimi për një gjë të tillë duhet fillimisht të miratohet nga Parlamenti.

Putini thotë se është i gatshëm për bisedime të paqes, por jo me Zelenskyn

MOSKË, 29 JANAR - Presidenti rus Vladimir Putin edhe një herë ka përjashtuar mundësinë e bisedimeve të drejtpërdrejta të paqes me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky, të cilin e quajti "jolegjitim". Kjo deklaratë nxiti udhëheqësin ukrainas që ta akuzojë Putinin se ka "frikë" që të negociojë një zgjidhje për luftën pothuajse trevjeçare. "Mund të negocioni me këdo, por për shkak të jolegjitimitetit të tij, ai [Zelensky] nuk ka të drejtë të nënshkruajë asgjë", tha Putini për televizionin shtetëror rus, "Rossiya 1TV", mbrëmjen e 28 janarit. Ai shtoi se do të "caktojë njerëz që të marrin pjesë" në negociata nëse Zelensky do të ishte prezent, në vend të mbajtjes së bisedimeve kokë më kokë. Putini disa herë ka deklaruar se nuk e konsideron Zelenskyn udhëheqës legjitim, pasi që mandati pesëvjeçar presidencial i tij është dashur të përfundojë më 20 maj të vitit 2024. Zgjedhjet do të duhej të mbaheshin më 31 mars të vitit



të kaluar, por u shtynë pasi shteti ende ka në fuqi gjendjen e luftës për shkak të pushtimit të nisur nga Moska. Zelensky, i cili, sipas Kushtetutës, duhet të vazhdojë të shërbejë derisa të zgjidhet një president i ri, iu përgjigj pretendimit të Putinit, duke thënë se udhëheqësi rus është pengesa për bisedimet për dhënien fund të luftimeve.

"Sot Putini edhe një herë konfirmoi se ka frikë nga negociatat, frikë nga udhëheqësit e fuqishëm dhe bën gjithçka që mundet për ta prolonguar luftën", shkroi Zelensky në rrjetet sociale. "Tani ne shohim se ka mundësi për arritjen e një paqeje të vërtetë, por Putini po bën gjithçka që ta vazhdojë vrasjen në shkallë të plotë në

vend të paqes, apo për një pauzë që të përgatitet për një pushtim të ri në shkallë të gjerë, duke kryer sulme hibride". Ukraina ka shpallur gjendje lufte që kur Rusia nisi pushtimin e saj në shkallë të plotë në shkallë të vitit 2022 dhe i duhet ta ndryshojë ligjin në mënyrë që t'i mbajë zgjedhjet në kohën kur gjendja e luftës është në fuqi. Zelensky po kërkon nga Shtetet e Bashkuara t'i bëjnë presion Moskës për t'i dhënë fund luftës, në mes të shtimit të raportimeve për negociata në prapaskenë për zgjidhjen e konfliktit, pasi Donald Trumpi mori detyrën e presidentit. Që kur u inaugurua më 20 janar, Trumpi ka kërcënuar me vendosjen e taksave dhe sanksioneve ndaj mallrave që shkojnë nga Rusia në ShBA dhe në shtete të tjera, nëse Moska nuk ulët në tavolinën e negociatave. "Nëse nuk arrini marrëveshje shpejt, nuk do të kem zgjidhje tjetër përpos që të vendos tarifa të larta dhe sanksione ndaj çdo gjëje që Rusia shet në ShBA dhe në disa shtete të tjera", shkroi Trumpi

më 22 janar në "Truth Social". Këto kërcënime, si duket, bien ndesh me lëvdatat që Trumpi i ka bërë në të kaluarën Putinit, me kritikën e ndihmës së ShBA-së për Ukrainën dhe dëshirës së tij për një përfundim të shpejtë të luftimeve, që nxiti shqetësim në mesin e mbështetësve të Ukrainës se ai do të mund t'i sakrifikoje interesat e Kievit në emër të një marrëveshjeje dhe kështu ta forconte Rusinë. Kremlini u është përgjigjur deklaratave të ashpra të Trumpit, duke thënë se në to "nuk ka ndonjë element të ri". Ukraina është duke humbur terren në fushëbetëj tash e pothuajse një vit, teksa ushtria më e madhe dhe e armatosur më mirë e Rusisë po vazhdon t'i thyejë mbrojtjet ukrainase dhe të shkaktojë viktima. Një nga problemet më të mëdha të Kievit është sfida për të rekrutuar ushtarë dhe të shkaktojë viktima. Një nga problemet më të mëdha të Kievit është sfida për të rekrutuar ushtarë dhe të shkaktojë viktima. Një nga problemet më të mëdha të Kievit është sfida për të rekrutuar ushtarë dhe të shkaktojë viktima.

Përpjekjet e Trumpit për ta hequr të drejtën e shtetësisë përmes lindjes

WASHINGTON, 29 JANAR - Urdhri ekzekutiv i presidentit Donald Trump për t'i dhënë fund të drejtës së shtetësisë përmes lindjes në Shtetet e Bashkuara ka shkaktuar një debat ligjor dhe politik rreth kompetencave të pushtetit ekzekutiv dhe Amendamentit të 14-t të Kushtetutës amerikane, i cili garanton

shtetësinë për këdo që lind në tokën amerikane. Ky rregull ka qenë shumë i rëndësishëm për të drejtat civile që nga ratifikimi i tij në vitin 1868. Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara, e hartuar në fund të shekullit të 18-të, ia la Kongresit pjesën më të madhe të vendimmarrjes për çështjen e imigracionit dhe

shtetësisë. Por presidenti Donald Trump ka nënshkruar një urdher ekzekutiv që i jep fund të drejtës automatike të shtetësisë për ata që lindin në Shtetet e Bashkuara. "Ne jemi i vetmi vend në botë që ofrojmë këtë të drejtë në lindje. Kjo është absolutisht qesharake. Ne mendojmë se kemi baza shumë të mira dhe

disa njerëz kanë dashur ta bëjnë këtë për dekada", tha ai. Kritikët e urdhrut ekzekutiv të presidentit Trump thonë se Amendamenti i 14-t është një gurthemel i të drejtave civile dhe nuk mund të ndryshohet nga një president i Shteteve të Bashkuara.



NATO-ja e gatshme të punojë me Sorensenin si ndërmjetësues në dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 29 JANAR - NATO-ja ka shprehur gatishmëri të punojë ngushtë me Peter Sorensenin kur ta nisë zyrtarisht punën e dërguar i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Pozita e tij është konfirmuar një ditë më parë, dhe ai do ta nisë punën më 1 shkurt. "Vazhdimi i bashkëpunimit në mes të NATO-s dhe BE-së është kyç për ruajtjen e stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor", ka thënë zëdhënësi i NATO-s, Allison Hart, përmes një postimi në X.

Dje i dërguari në shkuarje i BE-së për dialogun, Mirosllav Lajçak, ka thënë se është takuar me pasardhësin e tij, dhe janë duke u siguruar që transicioni të ndodhë sa më lehtë që është e mundur.

Lajçaku ka qenë në pozitën e ndërmjetësuesit për pesë vjet. Përgjatë mandatit të tij është arritur Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, por nuk është bërë asnjë hap drejt zbatimit të saj.

Po të martën emërimin e Sorensenit në pozitën e

ndërmjetësuesit e ka përsëritur edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, njëherësh kryenegociator i Kosovës në dialogun me Serbinë. Ai ka thënë se pret qasje balancuese ndaj palëve, si parakusht për proces të suksesshëm drejt normalizimit të marrëdhënieve. Sorensen ka përvojë të gjatë diplomatike në strukturat e BE-së. Ai aktualisht është këshilltar i lartë në Shërbimin e Veprimt të jashtëm të BE-së (EEAS) për diplomaci digjitale.

Gjatë karrierës së tij diplomatike në BE, Sorensen ka ushtruar disa detyra në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën, ku ka punuar në misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Përvoja e tij nga rajoni thuhet se ka qenë edhe një prej argumenteve se pse kryediplomatja Kaja Kallas ka vendosur që ai të jetë pasardhësi i Lajçakut.

Në të kaluarën, liderë të Kosovës, nisur nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani, e deri te kryeministri Albin Kurti, e kanë kritikuar Lajçakun për qasje të



pabalancuar në dialog dhe për rreshtim me raste kah Serbia.

Vetë Lajçaku pati thënë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, muaj më parë, se pretendime të tilla nuk qëndrojnë dhe pati vlerësuar se shoqëritë në Kosovë dhe Serbi, nuk janë të gatshme për normalizim.

Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel qysh prej vitit 2011.

Palët kanë arritur një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

Bashkimi Evropian ua rikujton dy palëve shpesh se avancimi në procesin e dialogut është i lidhur me rrugën e tyre në integrimet euroatlantike.

Serbia gëzon statusin e vendit kandidat për anëtarësim në bllokun evropian dhe tashmë ka hapur disa kapituj për

anëtarësim, ndërsa Kosova ka aplikuar të bëhet anëtare e BE-së, por aplikimi i saj nuk është shqyrtuar ende.

Kosova është e vetmja në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk ka status të vendit kandidat, ndonëse zyrtarë të lartë të BE-së thonë vazhdimisht se ardhmja e rajonit të Ballkanit është në bllok.

Mustafa: LDK-ja do të jetë fituese më 9 shkurt, LV ka filluar ta ushtrojë opozitarizmin pa përfunduar zgjedhjet



PRISHTINË, 29 JANAR - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se beson në rikthim të fuqishëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) më 9 shkurt. Mustafa, që ka udhëhequr LDK-në për mbi 10 vjet, ka thënë se kjo parti do të dalë fituese në këto zgjedhje. Në një deklaratë për "Reporterin", Mustafa e ka quajtur "masakër" e "lloj holokausti për zhbërje politike" atë që i kishte ndodhur LDK-së para katër vjetësh. "Mendoj se pas masakrës që iu bë LDK-së në vitin 2021 (një lloj holokausti për zhbërje politike)

nga shumë aktorë të brendshëm, por edhe ndërkombëtarë, ajo falë atyre që i qëndruan besnikë po rimëkëmbet, maskat e mashtrimeve dhe të profiterëve po bien, po merr përkrahje të gjerë të qytetarëve dhe do të dalë fituese, sepse e meriton", ka deklaruar Mustafa.

Tash e 19 ditë ka nisur fushata. Fushatën e opozitës Mustafa e ka cilësuar shumë të emancipuar, e për partinë në pushtet ka thënë se po përdor gjuhë ofenduese dhe denigruese në mungesë të rezultateve. Ai ka thënë se ka

filluar ta ushtrojë opozitarizmin ende pa përfunduar zgjedhjet. "Me mesazhe pozitive, oferta të qarta e respektim të qytetarëve, si LDK, PDK e AAK, por edhe Lista për Familjen, si subjekt i ri zgjedhor. Në të kundërtën LV-ja, në mungesë të rezultateve, po shërbehet me gjuhë ofenduese dhe denigruese. Kam përshtypjen se po e ofendon dhe dëmton më shumë vetveten sesa të tjerët. Ose nuk ka besim të qeverisë dhe ka filluar ta ushtrojë opozitarizmin para se të përfundojnë zgjedhjet", ka thënë Mustafa.

KQZ-ja dhe institucionet ligjzbatuese koordinohen për zgjedhjet e 9 shkurtit

Prishtinë, 29 janar - Institucionet shtetërore janë vënë në lëvizje për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor më 9 shkurt. Lidhur me zgjedhjet, të mërkurën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është mbajtur takimi në mes të drejtuesve dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme për të diskutuar për përgatitjet, bashkëpunimin dhe bashkërenditjen e aktiviteteve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në këtë takim, përveç

kryesuesit të KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, morën pjesë koordinatori Nacional për Zgjedhje në Prokurorinë e Shtetit, Laura Pula, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, anëtari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Artan Abazi dhe koordinatori nga ky institucion, Fatime Dërmaku, dhe kryesuesi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Zenel Leku. Në njoftim thuhet se kryesuesi i KQZ-së, Radoniqi,

vlerësoi se bashkëpunimi ndërinstitucional është thelbësor për krijimin e kushteve që procesi zgjedhor të zhvillohet sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Drejtnesit dhe përfaqësuesit e institucioneve treguan për planet e tyre lidhur me angazhimin në ditën e zgjedhjeve në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e procesit zgjedhor.





Beteja milionëshe për vota

Fushata zgjedhore në Kosovë është garë milionëshe. Ndonëse partitë politike janë të obliguara t'i raportojnë shpenzimet, vëzhguesit e zgjedhjeve ngrenë shqetësime për transparencën e donacioneve që ato marrin. Eugen Cakolli nga rrjeti i organizatave joqeveritare Demokracia në Veprim (DnV) pret që fushata aktuale të jetë më e kushtueshme krahasuar me të kaluarat sepse, siç thotë, është fokusuar në marketing në sferën digjitale

PRISHTINË, 29 JANAR - Partitë politike në Kosovë kanë të drejtë të shpenzojnë mbi dy milionë euro në fushatën për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, ose jo më pak se një euro për një votues të regjistruar. Kështu është e përcaktuar me Rregulloren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), e miratuar në muajin gusht të vitit të kaluar. Rregullorja specifikon se në zgjedhjet e përgjithshme, ato lokale dhe për kryetarë të komunave, kufizimi i shpenzimeve do të jetë në jo më pak se një euro për votues. Në zgjedhjet e mëparshme ka qenë 0.50 centë për votues. Për zgjedhjet e 9 shkurtit numri i votuesve të regjistruar është 2 075 868. Fushata zgjedhore ka nisur zyrtarisht qysh më 11 janar dhe do të zgjasë deri në ditën kur të hapen qendrat e votimit. Me fillimin e saj, partitë në garë kanë nisur edhe zyrtarisht shpenzimin e parave. Shpenzimet përfshijnë para për marketingun politik në televizione, rrjete sociale, shërbime të teknologjisë së

informacionit, udhëtime, tubime me kandidatë, karburante, punësim të stafit të nevojshëm për fushatë, logjistikë, ndriçim dhe sistem të zërimit për salla. Përveç këtyre, para nevojiten edhe për prodhimin e materialeve promovuese, si: kartëvizita, bluza, kapele, broshura, flamuj partiakë, video-xhirime profesionale etj., thotë Eugen Cakolli nga rrjeti i organizatave joqeveritare, Demokracia në Veprim (DnV), i cili monitoron fushatën zgjedhore. Por, publike deri më tash janë vetëm shpenzimet e bëra në rrjetet sociale. Kompania "Meta", e cila ka në pronësi "Facebook"-un dhe "Instagram"-in, publikon të dhëna për reklamat apo mesazhet e sponsorizuara politike. Duke analizuar një periudhë prej 30 ditësh, del se shpenzimet për fushatë në "Facebook", disa garues i kanë nisur para fillimit zyrtar të saj. Nga 26 dhjetori i vitit të kaluar deri më 24 janar të këtij viti, kandidatët për kryeministër të

Kosovës nga PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë shpenzuar mbi 23 mijë euro për sponsorizimin e materialeve zgjedhore në "Facebook". Vetëm kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, nuk ka sponsorizuar ndonjë material. Njësoj, edhe disa parti politike - për 30 ditë ato kanë shpenzuar mbi 20 000 euro. Për një muaj tri partitë më të mëdha politike - Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës - kanë harxhuar mbi 20 mijë euro për reklama në "Facebook". Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk figuron se ka shpenzuar para për sponsorizim. Radio Evropa e Lirë kontaktoi të katër partitë që kanë kandidatë për kryeministër - Lëvizjen Vetëvendosje me Albin Kurtin, Partinë Demokratike të Kosovës me Bedri Hamzën, Lidhjen Demokratike të Kosovës me Lumir Abdixhikun dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës me Ramush Haradinajn - por asnjëra nuk iu

përgjigj pyetjeve se sa para kanë shpenzuar për fushatë deri më tani dhe sa planifikojnë të shpenzojnë. Cakolli pret që fushata aktuale të jetë më e kushtueshme krahasuar me të kaluarat sepse, siç thotë, është fokusuar në marketing në sferën digjitale. Në vitin 2021 në Kosovë janë mbajtur dy palë zgjedhje - më 14 shkurt zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe më 17 tetor zgjedhjet lokale. Për të parat, fushata ka zgjatur dhjetë ditë për shkak të masave kundër pandemisë Covid-19, kurse për të dytat 30 ditë.

Si i sigurojnë paratë partitë politike?

Partitë politike financohen nga dy burime - nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët e jashtëm - në formë të parave të gatshme ose përmes kontributeve në mallra dhe shërbime. Financimi nga buxheti i shtetit bëhet çdo vit përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike. Ky fond në buxhetin e këtij viti - prej 3.6 miliardë eurosh - ka vlerën e 4.8 milionë eurove. Mjetet nuk janë shpërndarë ende për këtë vit, sepse rekomandimi i propozuar nga Zyra e Partive Politike në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk i ka marrë votat e nevojshme nga anëtarët e

KQZ-së. Përpjekje të reja pritet të ketë në muajt në vazhdim. Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike e kishte vlerën e njëjtë edhe vitin e kaluar: 4.8 milionë euro. Ndarja bëhet në bazë të përfaqësimit të partive politike në Kuvendin e Kosovës, që ka gjithsej 120 ulëse.

Sa përfituan partitë vitin e kaluar?

Nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, Lëvizja Vetëvendosje, si subjekti më i madh politik, përfitoi 2.2 milionë euro. Partia Demokratike e Kosovës mori mbi 760 mijë euro, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 640 mijë euro dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 320 mijë euro. Dhjetë partive të tjera të përfaqësuara në Kuvend iu ndanë nga më pak se 100 mijë euro.

Sa janë donacionet?

Me Rregulloren për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, partitë politike kanë të drejtë të pranojnë kontribute shtesë për fushatë nga persona fizikë dhe juridikë. Personat fizikë mund të japin deri në 2 000 euro,

Studimi tregon rritje të etnonacionalizmit dhe narrativit antigjinor në Kosovë

PRISHTINË, 29 JANAR - Etnonacionalizmi, narrativi antigjinor, ekstremizmi fetar dhe narrativi antiserb në Kosovë ndërlidhen mes vete, janë në rritje dhe kontribuojnë në ndarjet në shoqëri, u tha në një konferencë rajonale që u mbajt në Prishtinë më 29 janar.

Konferenca u organizua në kuadër të projektit "Lufta kundër ekstremizmit në Kosovë: trendët, sfidat dhe kundërmasat".

Projekti, i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, u zbatua nga organizata joqeveritare "Sbunker" në Prishtinë, me qëllim të ofrimit të një pasqyre të përgjithshme të ekstremizmit në Kosovë dhe të rekomandimeve për shtypjen e tij.

Adelina Hasani, hulumtuese dhe autore e këtij raporti, tha se etnonacionalizmi në Kosovë është pasojë e çështjeve të pazgjidhura nga vitet 1990 dhe ndodhive në luftë.

Nga mungesa e adresimit të drejtësisë tranzicionale, sipas saj, këtu dominon edhe diskursi politik. "Narrativët dhe ekstremizmi i djathtë janë duke u përhapur në Kosovë. Etnonacionalizmi është kryesisht i pranishëm mes shqiptarëve dhe serbëve në

Kosovë dhe kjo është e kuptueshme marrë parasysh trashëgiminë e viteve 1990. Megjithatë, etnonacionalizmi e thëllon ndarjen mes serbëve dhe shqiptarëve dhe e pengon procesin e pajtimit", tha Hasani.

Të dhënat për hulumtimin "Lufta kundër ekstremizmit në Kosovë" janë mbledhur kryesisht përmes diskutimeve publike në disa komuna të Kosovës, ndërsa janë përdorur edhe studime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ekstremizmin. Diskutime të tilla publike, megjithatë, nuk ka pasur në komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, për shkak të, siç u tha, situatës politike.

Në këto komuna, tensionet kanë qenë të larta viteve të fundit, për shkak të përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për të shtrirë autoritetin edhe në atë zonë, përkundër refuzimeve të komunitetit serb për t'u integruar.

Duke folur për trendin e etnonacionalizmit në mesin e komunitetit shqiptar në Kosovë, Hasani tha se ai vihet re kryesisht në narrativin në rrjetet sociale dhe në diskursin publik. Sipas saj, ka një "stigmatizim të

komunitetit serb".

Hasani theksoi, gjithashtu, se Kosova është një vend multietnik, por se përballet me "pengesa" për t'u bërë një shoqëri gjithëpërfshirëse, sepse autoritetet tregojnë mospërputhje në përdorimin e simboleve të Kosovës, siç është flamuri. "Përdorimi i flamurit shqiptar në shumë institucione sjell pasiguri jo vetëm për komunitetin serb, por edhe për komunitetet tjera pakicë në Kosovë", tha ajo.

Hasani shtoi se etnonacionalizmi në mesin e komunitetit serb është kryesisht i pranishëm në komunat në veri të Kosovës.

Sipas saj, ai është pjesërisht pasojë e dezinformatave që vijnë nga Rusia dhe përhapen përmes mediave në Serbi. "Në kemi narrativë që thonë se duan t'i dëbojnë serbët nga veriu i Kosovës - gjë që rrit frikën në mesin e komunitetit serb", tha ajo.

Përndryshe, edhe zyrtarët e Serbisë, edhe ata të Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit - i përkrahajnë shpeshherë veprimet e Qeverisë së Kosovës për shtrirjen e autoritetit në veri

si "persekutim i serbëve nga regjimi i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti".

Studimi "Lufta kundër ekstremizmit në Kosovë: trendët, sfidat dhe kundërmasat" identifikon edhe një narrativ antigjinor, që është i drejtuar kryesisht kundër popullatës LGBT dhe abortit. "Grupi që përdor narrativ të tillë, përpiqet ta mbrojë familjen tradicionale. Ai e sheh komunitetin LGBT si kërcënim, sepse beson se ai i shkatërron vlerat e familjes, se familja përbëhet nga babai, nëna dhe fëmija", tha studiuesja Adelina Hasani.

Sipas saj, narrativë të tillë kanë mbrojtur edhe deputetë të caktuar të Kuvendit të Kosovës. "Narrativi antigjinor është i pranishëm edhe në mediat sociale. Ai është i drejtuar kundër aktivisteve për të drejtat e grave", shtoi ajo.

Kur bëhet fjalë për ekstremizmin fetar, Hasani theksoi se ky fenomen në Kosovë ka arritur kulmin në vitin 2014, por se është ende i pranishëm në shoqëri. "Institucionet e sigurisë kanë qenë shumë të rrepta ndaj radikalizmit fetar dhe tani ai shprehet kryesisht në rrethe familjare. Ajo që unë shoh si

kërcënim, është se ekstremizmi fetar mund të ndikojë në zhvillimin e vlerave demokratike dhe të të gjithë shoqërisë. Ata që promovojnë ekstremizmin fetar, duan ta portretizojnë demokracinë si një sistem të korruptuar, të dështuar dhe ta promovojnë veten si alternativë", tha Hasani.

Kuptimi i këtyre trendëve, sipas saj, do të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve afatgjate për luftimin e tyre.

Studimi "Lufta kundër ekstremizmit në Kosovë: trendët, sfidat dhe kundërmasat" ofron një sërë rekomandimesh për institucionet në lidhje me rritjen e këtij fenomeni, duke përfshirë zhvillimin e programeve socio-kulturore për të rinjtë, gjetjen e mënyrave për të reduktuar ekstremizmin online dhe adresimin e çështjeve të drejtësisë tranzicionale dhe të narrativëve historikë.

Si pjesë e këtij projekti u hap edhe një faqe interneti që do të përfshijë një paketë mjeteve praktike, të krijuara për mësime të edukatorëve, udhëheqësve lokalë dhe të komunitetit, për t'i ndihmuar ata në parandalimin e ekstremizmit në një fazë të hershme. (REL)



ndërsa ata juridikë jo më shumë se 10 000 euro. Këto kontribute mund të jepen nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.

KQZ-ja e shpalli 9 shkurtin datë për zgjedhjet parlamentare në gusht të vitit të kaluar. Megjithatë, në raportet e fundit të publikuara në uebfaqet e partive politike, donacionet dhe kontributet nuk janë në shumta të mëdha financiare.

Në raportin financiar për periudhën korrik-shtator 2024 të Lëvizjes Vetëvendosje, në

kategorinë e donacioneve dhe kontributeve, thuhet se janë grumbulluar 3 227 euro, kurse nga anëtarësia 88 euro.

PDK-ja nuk ka të publikuar ndonjë raport për donacione për ndonjë periudhë të vitit 2024, ndërsa në periudhën shtator-dhjetor të vitit 2023, vetëm një person ka dhuruar 100 euro.

Për periudhën korrik-shtator të vitit të kaluar, sipas raportit të LDK-së, kjo parti ka mbledhur 2 995 euro donacione.

AAK-ja, ndërkaq, ka pranuar 5 058 euro donacione në tre muajt

e fundit të vitit të kaluar. Në të gjitha raportet e publikuara figurojnë edhe emrat e kontribuuesve, që në disa raste janë anëtarë apo edhe vetë kryetarë të partive.

Cakolli: Raportet nuk paraqesin gjendjen reale

Vlera e donacioneve është disa herë më e madhe se ajo që raportohet, thotë Cakolli nga DnV-ja. Sipas tij, partitë politike nuk i publikojnë donacionet që i japin kompanitë private. "Një

faktor që i shtyn kompanitë të mos i japin zyrtarisht donacionet, është ekzistimi i një dispozite ligjore, sipas së cilës, kur një kompani ofron donacion për një parti politike, ajo nuk mund të marrë kontrata publike për një periudhë së paku trevjeçare pas përfundimit të kontratës, si nga ana e institucioneve qendrore, ashtu edhe atyre lokale", shpjegon Cakolli për Radion Evropa e Lirë. Kjo, shton ai, "i dekurajon bizneset të japin donacione në mënyrë formale", porse kontributi i tyre në forma të

ndryshme nuk mungon. "Ka raste që pronarë të restoranteve, sallave apo kompanive që ofrojnë shërbime apo produkte të caktuara, u japin partive politike mjete pa pagesë. Për shembull, salla e restorantit lëshohet pa kompensim, ose ndriçimi, zërimi apo produkte të ngjashme ofrohen pa pagesë", thotë Cakolli. Me ligj, subjektet politike garuese në zgjedhje obligohen të dorëzojnë në KQZ raportin financiar të fushatës zgjedhore, jo më vonë se 30 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare.

John Ratcliffe dhe ndikimi i tij në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor gjatë administratës Trump



Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Gjatë mandatit të tij si drejtor i Zbulimit Kombëtar (DNI) në administratën Trump (maj 2020 - janar 2021), John Ratcliffe luajti rol kyç në formësimin e politikave të sigurisë dhe mbështetjes strategjike të ShBA-së në Ballkanin Perëndimor dhe Kosovë. Përmes koordinimit të agjencive kryesore të inteligjencës, ai ofroi analiza kritike për vendimmarrjen amerikane në rajon.

Mbështetja për sovranitetin e Kosovës dhe Marrëveshja e Uashingtonit

Një nga prioritetet e administratës Trump ishte përkrahja e sovranitetit të Kosovës dhe avancimi i njohjeve

ndërkombëtare. Ratcliffe luajti një rol të rëndësishëm në sigurimin e analizave të inteligjencës për sfidat dhe kërcënimet ndaj Kosovës, duke përfshirë ndikimet e jashtme nga Rusia dhe Kina. Marrëveshja e Uashingtonit (shtator 2020) përfaqësoi një moment kyç për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Ratcliffe siguroi që informacionet mbi përpjekjet destabilizuese të aktorëve të jashtëm të përdreshin për të mbështetur procesin. Marrëveshja përfshinte projekte ekonomike si ndërtimi i hekurudhave dhe autostradave, duke reduktuar varësinë e rajonit nga aktorët destabilizues.

Kundërshtimi i ndikimit rus dhe kinez

Ratcliffe dhe agjencitë që ai drejtonte identifikuan dhe ekspozuan përpjekjet e Rusisë dhe Kinës për të minuar sovranitetin e Kosovës dhe stabilitetin në Ballkan. Rusia: Përpjekjet e koordinuara për dezinformim dhe ndikim përmes medieve sociale dhe diplomacisë synonin të thëllonin ndarjet etnike dhe politike në Kosovë. Kina: Iniciativa "Rruga dhe Brezi" ofroi projekte infrastrukturore, por inteligjenca amerikane paralajmëroi

për rreziqet e varësisë ekonomike.

Siguria dhe lufta kundër terrorizmit

Kosova mbetet një partner i rëndësishëm i ShBA-së në luftën kundër terrorizmit. Në vitin 2020, operacioni për riatdhesimin e shtetasve kosovarë nga Siria u mbështet nga inteligjenca amerikane, duke siguruar informacione kritike për suksesin e tij.

Dialogu Kosovë - Serbi dhe pritjet për të ardhmen

Aktualisht, dialogu Kosovë-Serbi mbetet i bllokuar për shkak të tensioneve në veri dhe refuzimit të Serbisë për të njohur pavarësinë e Kosovës. 1. Zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese: Prioritet mbetet zbatimi i marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duke respektuar Kushtetutën e Kosovës. 2. Angazhimi i ShBA-së: Me inaugurimin e administratës Trump në janar 2025, pritjet një qasje më aktive në dialog. ShBA mund të ushtrojë presion për një marrëveshje historike, duke reduktuar ndikimin e Rusisë dhe Kinës. 3.

Tensionet në veri: NATO dhe KFOR po mbajnë një prani të shtuar për të garantuar stabilitetin.

Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar

Njohjet ndërkombëtare: ShBA mund të ndihmojë Kosovën të rikthejë njohjet e tërhequra dhe të sigurojë mbështetje nga vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur pavarësinë. Integrimi ndërkombëtar: Përpjekjet për anëtarësim në organizata si Këshilli i Evropës, INTERPOL dhe UNESCO do të jenë prioritare. Reformat e brendshme: Lufta kundër korrupsionit dhe zhvillimi ekonomik janë kritike për forcimin e shtetit dhe tërheqjen e investimeve ndërkombëtare. Kosova ndodhet në një moment historik, me sfida dhe mundësi përpara. Aktivizimi i administratës Trump dhe angazhimi i fuqishëm i BE-së mund të sjellin përparime në dialogun Kosovë-Serbi dhe forcimin e sovranitetit të Kosovës. Megjithatë, suksesi do të varet nga përkushtimi i institucioneve të Kosovës për të ruajtur stabilitetin e brendshëm dhe për të forcuar pozicionin ndërkombëtar.

Vota është arma më e fortë për t'i mposhtur antivlerat



Shkruan: Astrit GASHI

Në këtë vend ka një rregull të pashkruar: sa më shumë të kesh shitur veten, aq më shumë të quajnë patriot. Sa më shumë të kesh bërë pazare me historinë, aq më shumë të trajtojnë si shpëtimtar. Por ne nuk mund ta pranojmë këtë. Historia nuk është një mall që mund ta rishkruajë

kushdo sipas nevojës.

Dje je vonuar, sot është vonë! Unë nuk kuptoj "Zdravo - Pronto - Hello - Merhaba", por vetëm shqip "Tungjatjeta"! Nuk kam qenë, nuk jam dhe nuk do të jem kurrë aleat me ata që minuan vullnetin politik të shqiptarëve, me ata që ndërtuan karrierën duke shpikur afëra fantazmë, me ata që manipulonin të vërtetën për të mbrojtur karriget e tyre. Nuk mund të hesht kur përpjekjet për të zbardhur të kaluarën zëvendësohen me narrativa të rreme, ku viktima dhe agresori përzihen qëllimisht për të krijuar një histori të re, një histori që u përshtatet atyre që dje ishin në anën e gabuar. Nuk mund të hesht kur ata që dikur ishin pengesë për lirinë sot paraqiten si shpëtimtarë, ndërsa ata që dhanë

gjithçka për këtë vend sulmohen dhe denigrohen. Patriot ditën, biznes me armiqtë natën - kjo lojë nuk dhez më! E kemi parë këtë skenar shumë herë. Ata që dje bënë pazare kundër interesit kombëtar, sot dalin e japin leksione patriotizmi. Ata që dikur heshtën përballë padrejtësisë, sot sillen si shpëtimtarë të popullit. Ata që dikur bashkëpunuan me ata që deshën ta shkatërrojnë këtë vend, sot pretendojnë se po e mbrojnë. Hipokrizia ka arritur kulmin! Por historia nuk fal. Historia nuk harrohet dhe, mbi të gjitha, historia nuk blihet me para! Nuk ka pajtim pa drejtësi. Nuk ka unitet duke mohuar të vërtetën. Nuk mund të ndërtohet e ardhmja mbi gënjeshtër dhe manipulime. Nuk mund të lejojmë që heronjtë të trajtohen si fajtorë,

ndërsa ata që i shantazhonin dje, sot të paraqiten si viktima. Boll më! Nuk mund të bëheni lavatriqe të askujt! Dje, viktima që dikush deshë ta "vraste". Sot, patriot që shitet si i persekutuar. Nesër, "shpëtimtar" i kombit. Jo! Kjo lojë ka marrë fund. Koha për heshtje ka mbaruar. Koha për të vërtetën ka ardhur. Dhe kushdo që përpiket të fshehtë të kaluarën, kushdo që bënë pazar me historinë, kushdo që shitet e blihet për interesa personale, do të dalë në dritë. Dikush po mendon se ky popull është analfabet funksional! Jo, jo! Por heshtja jonë vret. Prandaj jemi ku jemi! Ende është në dorën tonë t'i eliminojmë me votë. Sot kemi mundësinë, nesër është vonë!

Nderohen dëshmorët e rënë në Bishtazhin, Goden dhe Rogovë të Hasit

GJAKOVË, 29 JANAR - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me familjarë të dëshmorëve, bashkëpunëtorë, bashkëluftëtarë, miq dhe qytetarë, në 26-vjetorin e përjetësimit, nderoi kujtimin për dëshmorët e kombit, të rënë në Bishtazhin, Goden dhe Rogovë të Hasit. "Epokën e luftës për liri heronjtë e vulosën me gjak, sepse liria asnjëherë nuk vjen si dhuratë nga dikush, por ajo fitohet me sakrificat e mëdha. Prandaj, nderimi e respekti për ata që qëndruan dhe u flijuan, është dhe do të jetë i

përjetshëm. Kur rrëfejme për heroizmin e tyre, kujtojmë betejat tek Ura e Terzive afër Bishtazhinit, Gradishin, Godenin dhe Rogovën e Hasit. Me dhimbje e krenari, sot e përjetë, kujtojmë emrat: Agron Rama, Agim Zeneli, Sejdi Rama, Agush Gjocaj, Bahtiar Morina, Daut Kelmendi, Emrush Çetaj, Gaspër Karaqi, Gëzim Ademaj, Hamdi Berisha, Haxhi Kleçka, Ilir Merturi, Kasim Shala, Luan Smajli, Memë Lleshi, Prend Lleshi, Naim Dreshaj, Naim Gashi, Sahit Krasniqi, Valon Gashi

dhe Vesel Avdyli", ka theksuar Latifi. Ai ka shtuar se më 29 janar, në përpjekje për t'i strehuar e shpëtuar luftëtarët dhe të plagosurit, nga forcat speciale serbe u vranë Rustem Morina me djemtë Selmanin, Muhametin e Nusretin, Ibrahim Kryeziu, Xhevdet Berisha, Zyber Shala, Adem Shala dhe Rifat Shala nga Rogova. "Qoftë i paharruar 27, 28 dhe 29 janari i vitit 1999! Lavdi dhe nderime për jetë e mot gjakut të derdhur për liri!", ka thënë Latifi.



Rama: Përmes Termokosit po i japim kuptim Prishtinës së Gjelbër

PRISHTINË, 29 JANAR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar për shpalljen e tenderit për projektin "Solar4Kosovo II - Ngrohja Qendrore Solare", Loti 1 - Impianti i Ngrohjes Qendrore. "Përmes realizimit të këtij projekti do të kemi mundësinë të ofrojmë shërbim për 32 000 qytetarë të Prishtinës në pesë lagje:

Tophane, Prishtina e Vjetër, Lakrishte, Kalabria dhe Mahalla e Muhaxherëve. Solar4Kosovo është projekti i vetëm i këtij lloji në Ballkan dhe i dyti më i madhi në Evropë për nga madhësia. Ai do të prodhojë energji të pastër termike me një kapacitet prej 50 MW, përmes paneleve solare termike me sipërfaqe 63 000 m² dhe një

rezervuari për akumulimin e ujit të ngrohtë me kapacitet 380 000 m³, ka shkruar Rama në "Facebook". Ai ka theksuar se përfitimet për Prishtinën në aspektin mjedisor do të jenë të mëdha, duke e vendosur kryeqytetin në hartën botërore të qyteteve të gjelbra. "Ky projekt do të mundësojë një kursim prej 44 000 tonësh CO në vit", ka shkruar Rama.



EULEX-i mirëpret njësinë policore të specializuar të 5-të për sigurinë gjatë zgjedhjeve në Kosovë

PRISHTINË, 29 JANAR - Shefi i Misionit EULEX i ka shprehur mirëseardhje Njësisë Policore të Specializuar të 5-të (NJPS). Këta policë, që vijnë nga forcat e Eurogendforit të siguruara nga Xhandarmëria Kombëtare e Francës, Karabinierët e Italisë, Shërbimi i Sigurisë Publike i Lituanisë dhe Garda Kombëtare Republikane e Portugalisë, do të punojnë krah për krah me Njësinë Policore të Specializuar (NJPS) të siguar nga Policia e Polonisë për ta përbushur

mandatin e Misionit për ta mbështetur stabilitetin në mbarë Kosovën dhe për garantimin e sigurisë për të gjitha komunitetet gjatë zgjedhjeve të 9 shkurtit. EULEX-i vepron si reaguesi i dytë i sigurisë në Kosovë në kuadër të mekanizmit me tre nivele të reaguesve të sigurisë, ku Policia e Kosovës është reaguesi i parë i sigurisë, EULEX-i është i dyti dhe misioni KFOR i udhëhequr nga NATO është i treti.



FSK-ja trajnon personelin e GIZ-it

PRISHTINË, 29 JANAR - Në Qendrën Ndërkombëtare Trajnuese për Kërkim Shpëtim (QNTKSh) është zhvilluar me sukses Trajnimi i Ndihmës së Parë për pjesëtarë të personelit ndërkombëtar dhe lokal të "Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit" GIZ, duke përfshirë pjesëmarrës nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Ky trajnim intensiv kishte në fokus teknikat e shpëtimit të jetës, reagimin emergjent dhe aftësitë praktike të ndihmës së parë, duke synuar rritjen e gatishmërisë së pjesëmarrësve për përballimin e situatave kritike. Gjatë pesë ditëve të trajnimit pjesëmarrësit patën mundësinë të ushtrojnë teknika të ndryshme të shpëtimit dhe ndihmës së parë në skenarë realistë, duke forcuar aftësitë e tyre profesionale. Bashkëpunimi me GIZ-in në



organizimin dhe zhvillimin e këtij trajnimi thekson angazhimin tonë të përbashkët

për siguri, qëndrueshmëri dhe ndërtimin e kapaciteteve në rajon.

Hyn në fuqi marrëveshja për njohjen e patentëshoferëve në mes të Kosovës dhe Italisë

PRISHTINË, 29 JANAR - Ministria e Punëve të Brendshme i ka njoftuar qytetarët e Republikës së Kosovës se nga e mërkura ka hyrë në fuqi zbatimi i marrëveshjes reciproke për njohjen e patentëshoferëve në mes të Kosovës dhe Italisë.

Njohja e patentëshoferëve u mundëson qytetarëve ta bëjnë konvertimin e dokumenteve pa pasur nevojë t'u nënshtrohen procedurave shtesë, as nga pjesa teorike, as nga pjesa praktike. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje është një hap i rëndësishëm drejt integritimit të qytetarëve të Kosovës që jetojnë në Republikën e Italisë. Njëkohësisht, kjo marrëveshje do ta lehtësojë barrën



ekonomike për qytetarët që kanë nevojë ta ndërrojnë dokumentin. Finalizimi i këtij procesi është një hap i rëndësishëm për vendin tonë dhe qytetarët tanë, sepse me këtë rast do të riafirmohen raportet e shkëlqyera që gëzojnë Republika e Kosovës me Republikën e Italisë.

Policia zbulon një laborator për falsifikim të dokumenteve

PRISHTINË, 29 JANAR - Policia e Kosovës ka bërë me dije se ka zbuluar një shtëpi në Prishtinë që ka shërbyer si laborator i sofistikuar për prodhim të dokumenteve të falsifikuara, përfshirë pasaportat, kartat e identitetit

dhe patentë-shoferët. Përmes një komunikate për medie, policia ka thënë se ka arritur ta zbulojë shtëpinë pasi më 24 janar e ka ndaluar një automjet në të cilin ka gjetur dokumente të zbrazëta të shteteve të ndryshme të

botës. Shoferi me inicialet F. K. është arrestuar dhe i është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh. Policia ka thënë se në objektin e zbuluar ka arritur të sekuestrojë makina laserike, printerë, mbi 20 000

mikroçipa dhe mijëra dokumente nga 51 shtete të ndryshme të botës. Është bërë me dije se Prokuroria e Kosovës është duke e hetuar rastin si falsifikim i dokumenteve dhe krim i organizuar.



Pezullimi i ndihmave amerikane ndihet në mbarë globin

WASHINGTON, 29 JANAR - Organizatat që zbatojnë programe të financuara nga qeveria amerikane në mbarë botën kanë filluar ta shkurtojnë personelin, të mbyllën, ose po përgatiten për ndaljen e operacioneve, pas ngrirjes së pashembullt të gjitha ndihmave ndërkombëtare, të vendosur nga administrata e presidentit Trump. Të hënën mbi 50 zyrtarë të lartë të Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID, që po merreshin me zbatimin e urdhrin të presidentit për ngrirjen e ndihmave, u pezulluan nga puna me pagesë. Drejtori në detyrë i USAID-it tha se ai po heton nëse zyrtarët po u rezistonin urdhrave të presidentit Trump.

Qëndrimi i ShBA-së për dekada ka qenë që ndihma e dhënë vendeve të tjera, i kthehet mbrapsht Amerikës në formën e forcimit të sigurisë kombëtare, stabilizimit të rajoneve dhe përmirësimit të marrëdhënieve me partnerët.

Vendet aleate, ndër to Ukraina, po përpiqen të shpëtojnë një pjesë të fondeve për sigurinë e tyre nga masa e ngrirjes 90-ditore, të urdhëruar javën e kaluar nga presidenti Donald Trump, që pezulloi edhe programet e ndihmave dhe kreditë federale brenda Shteteve të Bashkuara. Administrata Trump thotë se urdhëroi ndalimin e ndihmës për vendet e tjera, për t'i dhënë kohë për të vendosur se cilat nga mijëra programet humanitare, të zhvillimit dhe të sigurisë, do të vazhdojnë të marrin fonde nga Shtetet e Bashkuara.

Ndërkohë, zyrtarët amerikanë urdhëruan që programet t'i ndalnin shpenzimet menjëherë. Përfshirja bëjnë vetëm programet ushqimore emergjente dhe ndihmat

ushtarake për dy vende aleate, Izraelin dhe Egjiptin.

Ngrirja do të thotë që p.sh. shkollave në Liberi do t'u duhet këtë javë t'i shkarkojnë kuzhinierët që ua përgatisin fëmijëve drekën. Mund të ndalen përpjekjet e Shteteve të Bashkuara për t'i ndihmuar bizneset amerikane jashtë vendit dhe për ta kundërshtuar ndikimin në rritje të Kinës. Veteranët në Ukrainë që marrin në një linjë telefonike kur gjenden në situatë krize, mund të dëgjojnë së shpejti një mesazh të regjistruar, pa mundësinë për të folur me dikë.

Shtetë globale e pasojave

Shtetet e Bashkuara janë deri më tani burimi më i madh në botë i ndihmave ndërkombëtare, megjithëse vendet e tjera japin një pjesë më të madhe të buxheteve të tyre. Shtetet e Bashkuara mundësojnë 4 nga çdo 10 dollarë që dhurohen për ndihma humanitare.

Punonjësit e ndihmave, zyrtarët lokalë dhe analistët, theksojnë se shkalla e ngrirjes ishte e vështirë për t'u kuptuar. "Komuniteti i ndihmave po përballet me faktin se sa ekzistencial është ky pezullim i ndihmës", tha Abby Maxman, presidente e organizatës Oxfam America, një nga të paktët zyrtarë të ndihmave që janë të gatshëm të flasin publikisht për ndikimin e ngrirjes, pas paralajmërimeve të administratës së presidentit Trump.

Por, shumë zyrtarë të administratës dhe ligjvënës republikanë besojnë se fondet e ndihmave për vendet e tjera duhet të shpenzohen në vend, ose të kursehen.



Ndihmat për ushtrinë e Ukrainës

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy thotë se ngrirja nuk ndikon në mbështetjen jetike amerikane për ushtrinë ukrainase, ndërsa lufton forcat pushtuese ruse. Kjo është përgjithësisht e vërtetë.

E vetmja kategori e ndihmës ushtarake për të cilën është përgjegjës Departamenti i Shtetit dhe për këtë arsye përfshihet nga pezullimi, është financimi ushtarak i huaj dhe edukimi dhe trajnimi ushtarak ndërkombëtar. Janë edhe disa programe të tjera për operacionet paqeruajtëse të OKB-së dhe programet e çmimit. Shumica e ndihmës ushtarake për Ukrainën është dhënë sidoqoftë nëpërmjet Pentagonit. Ajo përfshin një program që shfrytëzon rezervat ekzistuese të armëve dhe një tjetër të quajtur Iniciativa e Ndihmës për Sigurinë e Ukrainës, e cila përdoret për t'i paguar kontratat e armëve që nuk do të dorëzoheshin për një vit ose më shumë.

Asnjë nga programet e Departamentit të Mbrojtjes nuk preket drejtpërdrejt nga ngrirja,

megjithëse zyrtarët amerikanë thonë se as nuk është duke u përgatitur diçka. Por programet civile jetike për përpjekjet luftarake të Ukrainës vijnë nga Departamenti i Shtetit. Nuk ka ndonjë njoftim për përjashtimin e këtyre programeve. Kjo përfshin mbështetjen e pagave që Shtetet e Bashkuara ofrojnë për ta mbajtur funksionale qeverinë e Ukrainës pavarësisht prej dëmeve të luftës tek ekonomia.

Kjo mbështetje është e rëndësishme, tha Bradley Bowman i Fondacionit për Mbrojtjen e Demokracive. "Por unë mendoj se nëse aleatët tanë evropianë po e lexojnë mirë momentin politik në Shtetet e Bashkuara, ata më mirë të lëvizin, them me shpejtësi, në përpjekje për të marrë pjesën më të madhe të barrës, ose të gjithën".

Preken fondet për veteranët e Ukrainës dhe programe të tjera

Shtetet e Bashkuara kanë dërguar urdhra ndalimi për programet civile për ta mbështetur Ukrainën në luftë. Këtu përfshihet edhe 'Veteran Hub', një organizatë jofitimprurëse që menaxhon një

linjë telefonike për situata krizash, nga e cila përfitojnë rreth 1300 veteranë në muaj që telefonojnë për të kërkuar ndihmë sociale dhe psikologjike.

Pas marrjes së urdhrin për ndërprerje të operacioneve, Ivona Kostyna, drejtuese e projektit, kuptoi se mund të humbasë gati gjysmën e personelit prej 31 personash.

"Nëse do të kishim një muaj, le të themi, paralajmërim, madje edhe dy javë, do të ishte shumë më e lehtë për ne", tha ajo. "Mund të kishim arritur disi të merrnim masat për një periudhë. Por, thjesht, nuk pati ndonjë paralajmërim". Disa ditë para ngrirjes së fondeve amerikane, 'Veteran Hub' mori një telefonatë nga dikush në prag të dëmtimit të vetvetes, tha zonja Kostyna. Një punonjësi i linjës telefonike i dërgoi mesazh personit gjatë natës. "Dhe tani ajo që kemi është një linjë që nuk funksionon dhe në thelb nuk ka përgjigje, gjë që është e tmerrshme për ne", tha ajo.

Shqetësimet për humbje të terrenit përballë Kinës

Shtetet e Bashkuara janë përpjekur ta shtojnë praninë e tyre në Paqësorin Jugor për ta kundërshtuar ndikimin e Kinës, përfshirë edhe rritjen e shpenzimeve të USAID-it për vendet që janë ndër më të varurit nga financimi i programeve të zhvillimit. Gjatë vizitave në Paqësor më 2024, zyrtarët njoftuan mbi 15 milionë dollarë në shpenzime të reja, për ta përmirësuar reagimin ndaj fatkeqësive natyrore, për ta mbështetur rritjen ekonomike, për t'i ndihmuar vendet t'i përballojnë efektet shkatërruese të ndryshimeve klimatike dhe më shumë.

Gërxfhaliu: Sanksionet e BE-së dhe ngrirja e ndihmës nga ShBA-ja, goditje të rënda për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë

PRISHTINË, 29 JANAR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxfhaliu, ka thënë se situata ekonomike në Kosovë po rëndohet çdo ditë, veçanërisht për sektorin privat dhe ekonominë familjare. Ai ka thënë se pasojat e sanksioneve të Bashkimit Evropian dhe ndërprerja e ndihmave nga ShBA-ja po ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin ekonomik të vendit, duke shkaktuar humbje të konsiderueshme financiare dhe duke frenuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Kosovë. "Deri më tani dëmi ekonomik i shkaktuar nga sanksionet e BE-së ndaj Kosovës llogaritet të ketë tejkaluar 900 milionë euro. Këto fonde, të cilat



ishin të planifikuara për projekte infrastrukturale, ndërtimore, arsimore, edukative dhe kulturore, do të kishin gjeneruar rritje ekonomike, punësim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Mungesa e tyre ka prekur drejtpërdrejt sektorin privat dhe institucionet publike, duke sjell një rënie të aktivitetit ekonomik dhe ulje të likuiditetit në treg, në veçanti sektorin prodhues. Për

më tepër, ndërprerja e ndihmave dhe mbështetjes nga ShBA-ja për organizatat amerikane në vendet e huaja, përfshirë Kosovën, përbën një tjetër goditje të madhe. Sipas vlerësimeve, nëse kjo situatë vazhdon gjatë gjithë vitit, Kosova do të humbasë të paktën 40 milionë euro nga fondet e USAID-it", është shprehur ai, duke shtuar se kjo do të ndikojë në sektorin privat, i cili do të mbetet pa qasje në grante, kontrata për tender të ndryshëm dhe mbështetje financiare që kanë qenë burim i rëndësishëm për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e biznesit. "Në këtë situatë të vështirë, institucionet e Kosovës duhet të veprojnë me urgjencë për ta

mbështetur sektorin privat dhe ekonominë familjare. Ndikimi i drejtpërdrejtë i këtyre masave do të reflektohet në fuqinë blerëse të qytetarëve, në rritjen e pasigurisë ekonomike dhe në mungesën e cashflow-it për bizneset, duke vështirësuar funksionimin e tyre dhe duke rritur rrezikun e falimentimit. Koha për veprim është tani. Qeveria dhe institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin hapa konkretë për t'i kompensuar humbjet dhe për të krijuar mekanizma të mbështetjes për sektorin privat. Përndryshe, dëmi ekonomik do të vazhdojë të thellohet, duke ndikuar në rritjen e papunësisë dhe pasigurisë sociale në vend", ka theksuar Gërxfhaliu.

Mos kini frikë! Inteligjenca Artificiale do e fuqizojë njerëzimin

Nga Reid HOFFMAN

Kohët e fundit kam kuptuar një mënyrë të re se si njerëzit po përdorin inteligjencën artificiale. Ata i kërkojnë ChatGPT-së: “Bazuar në gjithçka që di për mua, më vizato një pamje të asaj që mendon se duket jeta ime e tanishme.”

Si një lexues mendjesh në një panair, ChatGPT duket se përzier parashikime të sigurta me detaje më specifike. Shpesh prodhon imazhe të njerëzve të ulur në një zyrë shtëpie përpara një kompjuteri. Ndoshta në një cep gjendet një kitarë akustike apo një mace ngjyrë portokalli endet në sfond. Por ndonjëherë, në mes të tavolinës, mund të shfaqet diçka e pazakontë, si për shembull, një brokoli i madh. Elemente të tilla të çuditshme janë ato që u japin këtyre portreteve jo vetëm një hijeshi të veçantë, por edhe momente epifanie. Duke përthithur përzierjen e gjerë të pyetjeve për punën, objektivat personale dhe gjithçka tjetër që përbën historikun tonë të bisedave me ChatGPT, sistemi zbulon modele dhe lidhje që mund të mos jenë menjëherë të dukshme. Në këtë mënyrë, këto portrete jo thjesht pasqyrojnë, por edhe zbulojnë. Përballë këtyre përshkrimeve, një përdorues mund të ndjejë nevojën të pyesë: A i përmend vërtet kaq shpesh perimet në bisedat e mia, sa që ChatGPT mendon se janë një pjesë qendrore e jetës sime?

Si anëtar i bordit të Microsoft dhe një nga financuesit e hershëm të zhvilluesit të ChatGPT, OpenAI, kam një interes të madh personal në të ardhmen e inteligjencës artificiale. Por interesi im nuk është vetëm financiar. Unë besoj me të vërtetë se duke u dhënë miliarda njerëzve akses në mjete të inteligjencës artificiale, të cilat mund t'i përdorin në çfarëdo mënyre që zgjedhin, ne mund të krijojmë një botë ku I.A. përforcon dhe amplifikon krijimtarinë dhe punën njerëzore, në vend që thjesht ta zëvendësojë atë.

Prandaj më duken kaq magjepsëse këto portrete të krijuara nga ChatGPT: Ato qartësojnë dhe dramatizojnë shqetësimet e vazhdueshme mbi identitetin dhe privatësinë në epokën dixhitale. Saktësisht sa gjëra kujton ChatGPT? – duket se pyesin, në mënyrë të nënkuptuar. Sa me maturi i përpunon këto kujtime dhe kush përfiton më shumë nga ky proces? Si përdorues i këtyre teknologjive, a ndihesh sikur po monitorohesh në mënyra që të bëjnë të ndihesh i

eksponuar, i kontrolluar dhe i manipuluar? Apo ndihesh i kuptuar?

Pak teknologji vërtet të fuqishme vijnë pa asnjë risk. Ndoshta palë të treta me motive dhe vlera të ndryshme nga tonat do të mund të fitojnë akses në të dhënat tuaja. Pasi të jenë në dijeni të modeleve të sjelljes suaj nga e kaluara, këto palë mund të jenë në gjendje të parashikojnë dhe të ndikojnë në vendimet tuaja të ardhshme. Edhe pse e pranoj që disa njerëz i shohin këto rreziqe si të pakapërcyeshme, nga përvoja ime personale kam zbuluar se ndarja e më shumë informacioni në më shumë kontekste mund të përmirësojë jetën e njerëzve.


Në shqetësimin tonë për dëmet e mundshme, është e lehtë të anashkalojmë shumë nga efektet pozitive që ka pasur teknologjia.

Unë bashkëthemelova LinkedIn, një rrjet social profesional, më shumë se dy dekada më parë, dhe ende sot marr një rrjedhë të vazhdueshme mesazhesh nga njerëz që kanë gjetur punë, kanë nisur biznese ose kanë bërë ndryshime premtuese në karrierën e tyre falë ndërveprimeve që kanë pasur në këtë platformë. Dhe e gjithë kjo ndodh sepse ata janë të gatshëm të ndajnë informacion mbi përvojën dhe aftësitë e tyre, në mënyra që dikur konsideroheshin si të pamenduara dhe të papërshtatshme.

Skeptikët e teknologjisë kanë përdorur prej kohësh mbiemrin “Orwellian” për të etiketuar gjithçka, nga funksioni i rekomandimeve të videove deri te aplikacionet e navigimit, si kërcënime për autonominë individuale, por historia e inovacionit teknologjik në shekullin XXI tregon një histori tjetër.

Tek “1984”, romani klasik i George Orwellit për shtypjen shtetërore, ekrane të fuqishme i mundësojnë një regjimi totalitar të sundojë mbi një popull të privuar nga liria, me një pushtet të pakontrolluar. Por sot jetojmë në një botë ku identiteti individual është monedha kryesore e vlerës — ku si hidraulikët ashtu edhe presidentët aspirojnë të bëhen influencues në rrjetet sociale dhe ku fuqia kulturore po rrjedh gjithnjë e më shumë drejt operatorëve të pavarur, përfshirë perandorinë e një njeriu të vetëm në podcaste, Joe Rogan, yllin gjigant të YouTube, MrBeast, dhe aktivisten për të drejtat e njeriut, Malala Yousafzai.

Unë besoj se inteligjenca artificiale është në një rrugë drejt, jo vetëm vazhdimin të kësaj prirjeje të fuqizimit



individual, por edhe drejt përmirësimit të saj në mënyrë dramatike.

Imagjinoni modele të inteligjencës artificiale të trajnuara mbi koleksione gjithëpërfshirëse aktivitësh dhe sjelljesh dixhitale. Një I.A. e tillë mund të ketë kujtesë të plotë mbi transaksionet tuaja në Venmo, pëlqimet në Instagram dhe takimet në Google Calendar. Sa më shumë të zgjidhni të ndani, aq më shumë kjo I.A. do të mund të identifikojë modele në jetën tuaj dhe të nxjerrë në pah të dhëna që mund t'i gjeni të dobishme.

Dekada më vonë, kur të përpiqeni të kujtoni saktësisht se cilat ngjarje dhe rrethana ju çuan më në fund të investoni plotësisht në Bitcoin, inteligjenca juaj artificiale mund të zhvillojë një hipotezë të informuar, bazuar në një regjistër të detajuar të përditësimeve të statusit tuaj, ftesave, mesazheve direkte dhe fragmenteve të tjera të jetës suaj dixhitale që shpesh mezi i vëmë re kur i krijojmë, e jo më disa ditë, muaj apo vite më vonë.

Kur të përballemi me vendimin nëse është koha për t'u zhvendosur në një qytet të ri, I.A. juaj do t'ju ndihmojë të kuptoni se si kanë evoluuar ndjenjat tuaja për shtëpinë përmes mijëra momenteve të vogla — gjithçka, nga tweet-et e irrituara për trafikun e përditshëm deri te ndryshimet dhe sa shpesh keni filluar të klikoni mbi ofertat e punës që ndodhen 100 km larg nga vendbanimi juaj aktual.

Për ata që zgjedhin ta përqafojnë këtë realitet të ri, mjetet që e bëjnë të mundur po shumohen dhe po evoluojnë me shpejtësi. Zhvilluesit e të gjitha përmasave po prezantojnë aplikacione dhe veçori që ju

lejojnë të regjistroni, ruani dhe analizoni automatikisht pothuajse çdo gjë — ose gjithçka — që bëni në kompjuterin, telefonin dhe pajisjet e tjera. Në këtë mënyrë, këto të dhëna kthehen në materialin për një lloj “uni” të dytë, i cili mund t'u japë edhe më të shpërqendruarve mes nesh një aftësi për të rishikuar të kaluarën me një nivel detajesh, që edhe shkrimtari Marcel Proust do ta kishte zili. Por kjo ndryshon më shumë sesa thjesht mënyrën se si ruajmë kujtimet tona. Ndërsa kritikët e Big Tech shpesh theksojnë se si I.A. mund t'u japë korporatave fuqi për të manipuluar ose diskriminuar njerëzit në bazë të të dhënave të tyre, ne mund të krijojmë gjithashtu I.A. të prapëtuara posaçërisht për t'u dhënë individëve më shumë aftësi për të nxjerrë njohuri nga të dhënat e tyre personale. Po sikur të kishit një I.A. që do të mund të analizonte modelet tuaja të shfletimit dhe t'ju paralajmëronte kur algoritmet e reklamave po ndikonin në vendimet tuaja të blerjes? Ose një I.A. që mund të zbulonte kur algoritmet e mediave sociale po e drejtonin vëmendjen tuaj drejt përmbajtjes gjithnjë e më ekstreme?

A humbasim diçka nga natyra jonë thelbësisht njerëzore nëse fillojmë të bazojmë vendimet tona më pak në intuitë, reagime të menjëhershme emocionale, fat, besim dhe mistikë? Apo rrezikojmë diçka edhe më thelbësore duke kufizuar ose madje duke hedhur tutje prirjen tonë instinktive për racionalizëm dhe iluminim intelektual?



Në një farë mase, të gjithë ne e ndjekim dhe e analizojmë veten dhe gjithmonë e kemi bërë këtë. Ne bëjmë lista

detyrash dhe mbajmë ditarë për aktivitetet tona të përditshme. Peshohemi dhe regjistrojmë hapat e përditshëm ose numrin e kilometrave që vrapojmë, zakonisht në ndjekje të një lloj përmirësimi personal ose të paktën ndërgjegjësimi për veten. Në fund të fundit, ciklet e vazhdueshme të reflektimit, veprimit, vlerësimit dhe përmirësimit janë mënyra se si njerëzimi përparon dhe zgjeron vetë kuptimin e të qenit njeri.

Pra, imagjinoni një botë ku një I.A. e di që nivelet tuaja të stresit prirjen të ulen më shumë pas një seance loje “World of Warcraft”, sesa pas një shëtitjeje në natyrë. Imagjinoni një botë ku një I.A. mund të analizojë modelet tuaja të leximit dhe t'ju paralajmërojë se jeni gati të blini një libër që ka vetëm 10 për qind mundësi që ta kaloni faqen e gjashtë.

Në vend që të funksionojë si një mekanizëm kontrolli dhe pajtueshmërie nga lart-poshtë, I.A. mund të na ndihmojë të kuptojmë veten, të veprojmë sipas preferencave tona dhe të realizojmë aspiratat tona. Në këtë mënyrë, kujtesa e përsosur nuk është thjesht një mjet për të mbajtur mend të kaluarën. Ajo bëhet një busull që na ofron një kuptim më të qartë të synimeve tona dhe përmirëson procesin tonë të vendimmarrjes. Ajo i shndërron gjurmët tona dixhitale nga regjistrime pasive të asaj që kemi qenë në burime dinamike që na ndihmojnë të formësojmë atë që duam të bëhemi — me një vetëdije më të madhe dhe me lirinë për të jetuar jetën sipas zgjedhjeve tona. / The New York Times – Bota.al

Z. Hoffman është bashkëthemelues i LinkedIn dhe anëtar i bordit të Microsoft.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Elan Raci përforcon Dukagjinin

KF Dukagjini nga Klina është përforcuar me sulmuesin Elan Raci. 21-vjeçari ka vendosur t'i bashkohet skuadrës që

drejtohet nga Ismet Munishi pas një aventure në futbollin zviceran. "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë për marrëveshjen e arritur me

sulmuesin e ri Elan Raci. 21-vjeçari ka vendosur ta vazhdojë karrierën në atdhe, pas disa aventurave në Zvicër. Elani së fundi ishte

pjesë e të rinjve të Neuchatel Xamax FCS. Ai është bashkë me pjesën tjetër të ekipit në fazën përgatitore në Turqi dhe

është gati ta japë kontributin për arritjen e objektivave. Mirë se vjen në shtëpi, Elan Raci!", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Krasniqi pritet të rizgjidhet në krye të KOK-ut



PRISHTINË, 29 JANAR - Presidenti aktual i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, pritet ta fitojë edhe një mandat katërvjeçar për ta drejtuar organizatën kryesore sportive në vend. Krasniqi deri më tani është kandidati i vetëm për president. Një prej nënpresidentëve aktualë të KOK-ut, Milaim Kelmendi, kishte njoftuar se do të kandidonte për president, por ndërkohë ka ndryshuar mendje. Të martën mbërma Komisioni Zgjedhor i KOK-ut i njoftoi federatat sportive me kandidaturat e deritashme. Kandidaturat paraqiten pikërisht nga federatat. Dhe në raportin e këtij komisioni shkruan që kandidatura e vetme për kryetar është ajo e Ismet Krasniqit. Ai mori drejtimin e Komitetit Olimpik të

Kosovës në vitin 2021. Më parë kishte drejtuar Federatën e Karatesë së Kosovës. Sipas raportit, Krasniqi bazën deleguese e ka nga atletika. Për nënpresidentë të KOK-ut deri më tani kanë kandiduar Arben Fetahu i basketbollit, Fatmir Makolli i krikboksit, Gazmend Maxhuni i triatlonit, Gentiana Beqa Ahmeti e volejbollit, Milaim Kelmendi i skijimit dhe Musa Selimi i sportit universitar. KOK-u i ka katër nënpresidentë. Për anëtarë të Bordit Ekzekutiv kandidaturë kanë paraqitur Astrit Hasani (peshëngritje), Agron Dida (autosporte), Agron Dubovci (sporti shkollor), Avni Nuha (çiklizëm), Avni Kuçi (aeronautikë), Bahri Gjinovci (volejboll), Bashkim Haxhimusa (not), Besire Domaniku

(mundje), Bujar Turjaka (skijim), Florian Miftari (basketboll), Halil Sylejmani (atletikë), Jeton Hadërgjonaj (tenis), Teuta Beselica Berbatu (ragbi) dhe Vjollca Krasniqi (futboll). Asambleja Zgjedhore e KOK-ut mbahet më 7 shkurt. Derisa garë për president nuk ka, gara për nënpresidentë dhe anëtarë të Bordit vlerësohet shumë e fortë. Dhe lista e kandidatëve nuk është përfundimtare. Pritet të shtohen edhe disa kandidatë për nënpresidentë e anëtarë të bordit nga federata që i kanë kuvendet zgjedhore këtë javë. Ka diskutime të shumta lidhur me bazën deleguese të disa kandidatëve e po ashtu për tendencën për rritje të ndikimit në KOK-u të mësimdhënësve të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit.

SHKURT

Hasani shkëput kontratën me Rapidin

Aventura e Florent Hasanit te Rapid Bukureshti ka marrë fund, pasi palët tashmë kanë arritur marrëveshje për shkëputjen e kontratës. Mediumet rumune kanë raportuar se Hasani tashmë është lojtar i lirë dhe largohet nga Rapidin vetëm pas një viti. Ai iu bashkua Rapidit në janar të vitit të shkuar nga Tirana dhe me skuadrën rumune firmosi kontratë deri në verën e vitit 2026. Hasani nuk bën pjesë në planet e ekipit rumun për pjesën e dytë të këtij sezoni dhe së shpejti pritet të transferohet diku tjetër si lojtar i lirë. Këtë sezon Hasani ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 1 asistim në 14 paraqitje kampionale për Rapidin e Bukureshtit.

Nga Berisha te Pogba, ja formacioni me lojtarët e lirë

Afati kalimtar dimëror do të mbyllet më 3 shkurt, një muaj pas hapjes zyrtare. Nuk kanë munguar lëvizjet në ekipe të ndryshme, por ka ende lojtarë shumë të njohur që nuk kanë mundur të gjejnë skuadër. I pari në portë është Etrit Berisha. Gardiani shqiptar, në moshën 35-vjeçare, pasi veshi fanellën e ekipeve si Lazio, Atalanta apo Empoli ka mbetur pa skuadër. Ai ka luajtur 160 ndeshje në elitën e futbollit italian. Në mbrojtje është dyshja e njohur Cendric Soares dhe Sergio Ramos. Nga krahët janë Amartey dhe Marcelo Viera. Në mesfushë spikat një emër i njohur si Paul Pogba, i cili ka zgjidhur kontratën me Juventusin. Në këtë repart janë dhe dy emra si Coquelin dhe Rafinha. Në sulm tre lojtarët e njohur që kanë mbetur pa kontratë janë Castillejo, Keita Balde dhe Diego Costa. Edhe pse kanë luajtur me ekipe të njohura, moshë dhe forma e tyre nuk ka bindur askënd që t'i ofrojë një kontratë të re.

Të enjten Kuvendi i Punës dhe Kuvendi Zgjedhor i FHK-së

PRISHTINË, 29 JANAR - Sot (e enjte) mbahet Kuvendi i Punës dhe Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Hendbollit të Kosovës. Punimet e Kuvendit zhvillohen nga ora 14:00 në "Hotel International Prishtina". Fillimisht do të mbahet Kuvendi i Punës, ndërsa rendi i ditës përbëhet nga pika si: shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i Punës i 28 marsit të

vitit 2024; shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës për vitin 2024; shqyrtimi dhe aprovimi i raportit financiar dhe auditimit për vitin 2024; shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të Këshillit Mbikëqyrës të FHK-së; shqyrtimi dhe aprovimi i plotësimeve dhe ndryshimeve në Statutin e FHK-së; aprovimi i planit të veprimit dhe planifikimit financiar për

vitin 2025. Më pas është pjesa zgjedhore. Do të zgjedhet presidenti i ri i FHK-së për periudhë katërvjeçare, nënpresidenti, anëtarët e bordit dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Kandidati i vetëm për president është Edin Kolgeci. Presidenti aktual i FHK-së, Eugen Saraçini, është në fund të mandatit të tretë, sa edhe lejohen maksimalisht me Statut të federatës.



Lojtari i vitit 2024, Gjimshiti: Ky vlerësim më jep shtysë shtesë dhe motivim

BERGAMO, 29 JANAR - Kapiteni i Kombëtares kuqezi dhe klubit të Atalantës, Berat Gjimshiti, u zgjodh lojtari shqiptar më i mirë i vitit 2024. Një çmim i akorduar nga Federata Shqiptare e Futbollit në ceremoninë e magjishme të "Topi të Artë 2024". Mbrojtësi u shfaq i lumtur me këtë vlerësim, pasi

çmimi u mor nga nëna e tij. "Jam shumë krenar, shumë i lumtur me këtë çmim. Ky vlerësim sigurisht që më jep një shtysë shtesë dhe motivim për Atalantën, por edhe për ekipin kombëtar. Falënderoj të gjithë stafin dhe lojtarët e skuadrës shqiptare. Nëna ime ishte shumë e kënaqur, por edhe

pak nervoze. Nuk dinte se çfarë të thoshte, por i thashë që të qëndrojë e qetë dhe të veprojë sikur po flet me mua. Asgjë të veçantë dhe ajo e bëri shumë mirë", u shpreh Gjimshiti. Përzgjedhja e tij "Lojtar i Vitit i Kombëtares" u bë nga votat e lojtarëve të Kombëtares. Gjimshiti, që aktivizohet me Atalantën në

Serinë A dhe mban shiritin e kapitenit të Kombëtarja shqiptare, ka pasur një vit të jashtëzakonshëm. Ai udhëhoqi Atalantën drejt triumfit historik në UEFA Europa League dhe ishte lojtar kyç në përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë në Kampionatin Evropian "Gjermani 2024".



Bayerni ndryshon strategji, ul pagat dhe do t'i mbështesë të rinjtë

MUNCHEN, 29 JANAR - Te Bayern Muncheni duket se po ndryshojnë strategji. Nëse deri sot ishim mësuar ta shihnim klubin bavarez të ishte një prej skuadrave me potencialin më të madh financiar jo vetëm në Gjermani, por edhe në Evropë, tashmë duket se gjermanët kanë ndryshuar planin. Strategjia do të jetë e diktuar sigurisht edhe nga kriza financiare, që ka prekur edhe klubet më të mëdha të Evropës. Revolucioni do të nisë nga pagat e futbollistëve, të cilat aktualisht kanë pësuar rritje nga 320 mln euro në 340 mln euro. Nuk do të ketë më lojtarë të mbipaguar, me bavarezët që do të synojnë t'i mbështesin lojtarët e rinj e të talentuar që kanë në gjirin e tyre. Kështu bordi i Bayernit duket i qartë në pozicionimin e tyre. Objektiv do të jetë rinovimi i Davies deri në 2030 e më pas zgjatja e kontratave dhe mbështetja të lojtarët e rinj si Pavloviq (20-vjeçar) dhe Bischof (19-vjeçar). Me



Thomas Mullerin që është në perëndimin e karrierës edhe senatorët e tjerë nuk duket se do të kenë më vend në projektin e së ardhmes të bavarezët. Kështu Leon Goretzka duket se nuk do të rinovojë pas përfundimit të sezonit. E përditshmja gjermane "Sport Bild" bën me dije ditën e sotme se vendimi tashmë është marrë, pas

takimit të drejtuesve më të lartë të klubit dhe agjentëve të mesfushorit. Goretzka do të largohet me shumë gjasë menjëherë pas përfundimit të sezonit. Në këtë mënyrë do të nisët të vihet në jetë projekti i Bayernit, për shfryrjen e buxhetit të klubit, dedikuar pagave tepër të larta, që aktualisht ka në klubin më të titulluar në Gjermani.

Golden State rikthehet te fitorja, mbrëmje zhgënjyese për lakersat dhe Milwaukeeen

OHIO, 29 JANAR - Ditë zhgënjyese për disa nga skuadrat pretendente për titull në NBA. Pas katër fitoresh radhazi, skuadra e lakersave u mund me rezultat 118-104 nga Philadelphia. LeBron Jamesi realizoi 31 pikë, por që s'mjaftuan për lakersat, ndërkohë që për vendasit shkëlqeu Tyrese Maxy me 43 pikë. Humbet edhe skuadra e Milwaukeees, që u ndal me shifrat 125-112 nga Portlandi. Antetokounmpo realizoi 39 pikë e 12 rebounde për Bucksin, por që mbetën për



statistikë. Për Portlandin u dallua Deni Avdija me 30 pikë. Rikthehet te fitorja ekipi i Golden States, që mundi me

REZULTATET

Atlanta - Houston	96-100
Philadelphia - Lakers	118-104
Golden State - Utah Jazz	114-103
Portland - Milwaukee	125-112

rezultat 114-103 Utah Jazzin. Vendimtar stoli i skuadrës së Warriorsit, nga erdhën 51 pikë. Fitore të vështirë korri jashtë fushës Houstoni, që mundi me rezultat 100-96 Atlantan. Jalen Green me 25 pikë ishte lider në fushë për miqtë.

SHKURT

Përfundon sezoni për Brojën

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, do të mungojë për pjesën e mbetur të sezonit, por nuk do të largohet nga skuadra e Evertonit. Broja këtë sezon ka pasur vazhdimisht probleme me lëndimet, por dëmtimi i fundit që e pësoi më 4 janar kundër Aston Villas doli të jetë fatal për 23-vjeçarin. Shkaku i këtij lëndimi, Broja nuk do të luajë këtë sezon, edhe pse deri më tani ka regjistruar vetëm 5 paraqitje për Evertonin në Premier Ligë. Në fakt, Broja u huazua i lënduar tek Evertoni nga Chelsea dhe arriti të rikuperohet për të debutuar këtë sezon më 4 dhjetor përpara se të dëmtohet një muaj më vonë. Edhe pse Evertoni ishte në bisedime me Chelsea për ta ndërprerë huazimin e Brojës para kohe, është marrë vendim që sulmuesi shqiptar të mos kthehet në "Stamford Bridge". Broja ka kontratë me skuadrën e Chelseat deri në vitin 2028, ndërsa Evertoni kishte opsionin e blerjes së tij këtë verë për 20 milionë euro.

Verstappeni: Kam mësuar më shumë nga gabimet e mia

Rruga e Max Verstappenit drejt katër titujve kampionë bote në Formula 1 ka qenë herë e lehtë e herë e vështirë. Piloti holandez, i cili hyri në cirkuit në një moshë shumë të re, ka konfirmuar se është një talent në këtë sport. Gjithsesi, ai konfirmoi në pistë edhe se kishte prirje për aksidente dhe një stil drejtimi tepër "të pamatur", duke marrë mjaft kritika nga kolegët e komisarët e garave. Megjithatë, duke kthyer kokën pas, Verstappenin nuk e ndien nevojën t'i japë vetes ndonjë këshillë. "Sinqerisht nuk do t'i jepja vetës asnjë këshillë", ka thënë 27-vjeçari që piloton një Red Bull në Formula 1: "Në fund të fundit, në jetë duhet të bëni edhe gabime për të ecur përpara. Shpesh na duhet t'i mësojmë gjërat në mënyrën e vështirë, duke luftuar. Nëse gjithçka do të dihej paraprakisht, mendoj se do të ishte shumë e mërzitshme si në jetë ashtu dhe në garë. Sapo të bëni një gabim, kjo është e vetmja herë kur ndryshoni ose mësoni diçka. Kjo ka ndodhur edhe me mua", ka deklaruar Verstappenin.

Galatasaray i ofron Napolit 65 milionë për Osimhenin

Sipas "Corriere dello Sport", Napoli ka marrë një ofertë prej 65 milionë eurosh nga Galatasaray për blerjen e kartonit të Victor Osimhen në këtë merkato. Klubi turk, i cili verën e kaluar e mori sulmuesin nigerian në formë huazimi, ka ofruar 10 milionë më pak sesa klauzola e tij e lirim. Napoli e ka refuzuar menjëherë ofertën, i bindur se 75 milionë eurot e vendosura në klauzolë janë një çmim shumë konkurrues për kartonin e Osimhen. Ndërkohë, lojtari vazhdon të shkëlqejë në Turqi, duke shënuar 16 gola në 20 ndeshje që nga transferimi i tij.

Martinezi shihet si pasues i Lewandowskit në Barcelonë

Ylli i Interit, Lautaro Martinez, ka përfunduar në listën e dëshirave të Barcelonës për të qenë sulmuesi i ardhshëm i ekipit. Sipas "El Gol Digital",

Barcelona është e interesuar për nënshkrimin e sulmuesit të Interit, Lautaro Martinez. Klubi katalanas e sheh sulmuesin argjentinas si një zëvendësues të mundshëm

për Robert Lewandowskin, i cili po plaket dhe mund të largohet mes interesimit nga klubet e Arabisë Saudite. Martinezi thuhet se është i hapur për t'u bashkuar me

Barcelonën, pasi klubi spanjoll ishte përpjekur ta nënshkruante atë në të kaluarën, por u pengua nga vështirësitë financiare. Megjithatë, me Martinezin që

tani shihet si një lojtar kyç në Inter, çdo lëvizje nuk do të ishte e lehtë apo e lirë. Çmimi i sulmuesit argjentinas aktualisht vlerësohet të jetë 100 milionë euro.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



e-mail: qendraomnisport@gmail.com

Ndërmarrja Publike Lokale "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A., shpallë:

FTESE PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QERA TË HAPËSIRAVE FUNKSIONALE DHE AFARISTE

Ftoheni që të Ofertoni për marrje në shfrytëzim me Qera të Hapësirave Afariste, Sallave-(Zyre), të cilat janë pronë e NPL "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A. Hapësirat e evidentuara me poshtë u jepen me Qera personave juridik.

Hapësirat të cilat jepen me Qera:

Nr.	Hapësira	Destinimi	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m ²
1.	C3-314	Sallë për Ligjerata	90.00 m ²	4.00 €
2.	C3-307	Sallë për Ligjerata	90.00 m ²	4.00 €

Kushtet e Përgjithshme

1. Periudha e Qeradhënies është për 1 (një) deri në 3 (tre) vite, me mundësi vazhdimi.
2. Qeramarësi me anë të Nënshkrimit të Kontratës me Qeradhënësin, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një Qeraje Mujore në llogari të Qeradhënësit.

Ofertuesi duhet t'i dorëzoi këto dokumente:

1. Kopjen e Çertifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe numrit fiscal, (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit, (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m²
4. Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmohet se biznesi është aktiv,

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi i cili ka pasur lokal me Qera në NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. dhe nuk i është përmbajtur Kontratës së Qerasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes,
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara,
3. Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në Shpallje.

Personat Juridik të cilët duan t'i vizitojnë Hapësirat – Sallat (Zyrat) e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: 30.01.2025, deri me datën 08.02.2025 nga ora 10.00 deri në ora 15.00.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: 10.02.2025 nga ora 10.00 deri në orën 12.00, në zyrën e arhivës së Qeradhënësit NPL "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A.

Në pjesën e jashtme të Zarfit duhet të specifikohen:

1. Emri i Ofertuesit,
2. Nr i Hapësirës – Sallave (Zyrave) dhe
3. Adresat Kontaktuese, si: web-faqeja, e-mail, nr. i telefonit.

Ofertat do të hapen nga ana e Komisionit të formuar nga NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. me datë: 10.02.2025, nga ora:12:30, në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Administratës/Drejtorisë së NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. në Mitrovicë.

SH.A.
QENDRA
MULTIFUNKSIONALE
MITROVICË
Kryeshefi Ekzekutiv
Muhamet Sylejmani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets



Ftesë për Ankand Publik

Datë 29.01.2025

Referenca: AAPSK – 002/2025

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Cady, ngjyrë e bardhë viti i prodhimit 1999, dizel- për pjesë / Rishpallje	1 copë për pjesë	400.00€		
2	Audi 8Z A2 1.4, viti i prodhimit 2000,benzin- me targa vendore / Rishpallje	1 copë	1,350.00€		
3	VW Sharan, ngjyre e zeze viti i prodhimit 2003 – për pjese	1 copë për pjesë	1,100.00€		
4	Renault Kango, ngjyre e bardhë, viti i prodhimit 2001 - me targa vendore (i mungon librezja e qarkullimit)	1 copë	1,100.00€		
5	VW Golf 2 ngjyrë e kuqe viti i prodhimit 1988 - për skrap	1 copë për skrap	246.10€		
6	Audi 80 ngjyrë e kuqe viti i prodhimit 1985 - për pjesë	1 copë për pjesë	50.00€		
7	Fiat Croma, ngjyrë e hirit, viti i prodhimit 2008, dizel- me targa vendore	1 copë	3,500.00€		
8	VW Golf IV ngjyrë e bardhe -dizel - për pjesë	1 copë për pjesë	500.00€		
9	Nisan Patrol, ngjyre e zeze viti i prodhimit 1989- për pjesë	1 copë për pjesë	400.00€		
10	Opel Monterey 3.1 TD, ngjyre e zeze viti i prodhimit 1992- për pjesë	1 copë për pjesë	500.00€		
11	Skoda Octavia, ngjyre e hirit viti i prodhimit 2006- për pjesë	1 copë për pjesë	1,750.00€		
12	Golf III, ngjyre e hirit viti i prodhimit 1991,benzin- me targa vendore	1 copë	1,100.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 05.02.2025 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 05.02.2025, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë, kurse mallin me numër rendor 1 mund ta shikojnë me datë: 04.02.2025, prej orës 10:00-11:00 në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00. Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 258.

Thirrje për aplikim

"Konsoni - m" sh.p.k., NUI 811127316, po kërkon ofertues / kontraktor / kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

Paisje speciale / seperator i cili e ndane mishin nga ashti

Nr. Prokurimit 003/25 "Konsoni - m" sh.p.k

Emri: "Konsoni - m" sh.p.k

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit:

konsoni@gmail.com , Adresa: Livoc i Ulet, Gjilan, Republika e Kosovës, Tel: +383 (0) 044 50 40 40

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 15:00, në Adresë: "Konsoni - m" sh.p.k., Livoc i Ulet, Gjilan, Republika e Kosovës, Republika e Kosovës.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

